UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2425 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 25.09.2024 Pejë / Peć

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm** **Pejë, 25.09.2024**

Duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe neni 41 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I.** Ndryshohet dhe plotësohet pika I me nr. 3 e Vendimit nr. 2122 i dt. 30.08.2024, lidhur me themelimin e Komisionit të Ankesave ad-hoc për procesin e konkursit publik nr. 1967 dt.29.07.2024 për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë.

**II.** Zëvendësohet anëtarja e komisionit Znj. Diliko Kaçi – Zyrtare e Burimeve Njerëzore dhe anëtar i ri i këtij komisioni emërohet:

- Znj. Nurije Halili – Menaxhere për Burime Njerëzore nga Universiteti " Fehmi Agani" Gjakovë.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Përmes vendimit nr. 2122 datë 30.08.2024, është themeluar Komisioni i Ankesave ad-hoc për procesin e konkursit publik nr. 1967 dt.29.07.2024 për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë. Në përbërje të këtij komisioni bën pjesë edhe Znj. Diliko Kaçi – Zyrtare e Burimeve Njerëzore. Ky vendim plotësohet dhe ndryshohet pasi znj. Diliko Kaçi nga data 23.09.2024 është në pushim të lehonisë (vendimi nr. 2419 datë 24.09.2024). Për të shmangur vonesat në procedurat e shqyrtimit të ankesave nga komisioni dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi i cili parashikon që një zyrtar nga njësia e burimeve njerëzore duhet të jetë anëtar i komisionit është bërë zëvendësimi i saj. Zyra e burimeve njerëzore është e mbuluar nga drejtori dhe zyrtarja e burimeve njerëzore dhe për shkak të pamundësisë për të caktuar një përfaqësues tjetër nga kjo zyrë, është bërë zëvendësimi me një anëtar të ri në përputhje me II të dispozitivit të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** znj. Nurije Halili, Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1793 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 11
Data / Datum / Date: 15.07.2024 Pejë / Peć

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë, 12.07.2024**

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024 , U.d. Sekretarja e Përgjithshme e UHZ, nxjerr:

**V E N D I M**

**I.** Mahmut Sami Islek i angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror (UNISUM-2024), të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumë prej 400 euro (katërqind euro).

**II.** Kompenzimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024.

**III.** Obligohet zyra e financave të UHZ-së, për ekzekutimin e këtij vendimi.

**IV.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi t' i dërgohet:**

- Mahmut Sami Islek;
- Prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë;
- Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyres së Financave;
- Arkivit të Universitetit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1796 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 15.07.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë, 12.07.2024**

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024 , U.d. Sekretarja e Përgjithshme e UHZ, nxjerr:

**VENDIM**

**I.** Ermira Qosja e angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror (UNISUM-2024), të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumë prej 50 euro (Pesëdhjetë euro).

**II.** Kompenzimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024.

**III.** Obligohet zyra e financave të UHZ-së, për ekzekutimin e këtij vendimi.

**IV.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi t' i dërgohet:**

- Ermira Qosja;
- Prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë;
- Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyres së Financave;
- Arkivit të Universitetit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1838 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 19 07 2024 Pejë / Peć

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë, 19.07.2024**

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024 , U.d. Sekretarja e Përgjithshme e UHZ, nxjerr:

**VENDIM**

I. Rudina Ciko e angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror (UNISUM-2024), të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumë prej 30 euro (Tridhjetë euro).

II. Kompenzimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024.

III. Obligohet zyra e financave të UHZ-së, për ekzekutimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi t' i dërgohet:**

- Rudina Ciko;
- Prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë;
- Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyres së Financave;
- Arkivit të Universitetit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu Hasani
B Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1839 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date 19 07 2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**

**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë, 19.07.2024**

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024 , U.d. Sekretarja e Përgjithshme e UHZ, nxjerr:

**V E N D I M**

I. Xhezair Idrizi i angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror (UNISUM-2024), të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumë prej 48 euro (Dyzet e tetë euro).

II. Kompenzimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024.

III. Obligohet zyra e financave të UHZ-së, për ekzekutimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi t' i dërgohet:**

- Xhezair Idrizi;
- Prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë;
- Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyres së Financave;
- Arkivit të Universitetit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr./Br.: 2282 Nr. i faq/ Br. str.: 1
Data / Datum / Date: 18 09 2024

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**

**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë Dt. 18.09.2024**

Në mbështetje të nenit 41 pika 1.1. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë dhe nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**I.** Znj. Adelina Shala- Zyrtare Ekzekutive e KD-së, në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, përveç detyrave të parapara si Zyrtare Ekzekutive e KD-së, caktohet gjithashtu si zyrtare përgjegjëse për qasje në dokumente publike.

**II.** E lartëcekura nga pika 1 e këtij vendimi bënë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave të pranuara për qasje në dokumente publike, kryerjen e shqyrtimit fillestar të këtyre kërkesave, ruajtjen dhe mbajtjen e evidencave të këtyre kërkesave dhe raportimin rreth këtyre kërkesave.

**III.** Nëpunësja gjatë ushtrimit të detyrave si zyrtare përgjegjëse për qasje në dokumente publike do t'i kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me nenin 13 të Ligjit nr. 06/L- 081 për Qasje në dokumente publike.

**IV.** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës së z. Butrint Xhemajli, i cili më parë ka qenë i caktuar nga universiteti si zyrtar përgjegjës për qasje në dokumentet publike dhe për të siguruar vazhdimësinë e procesit të punës pa pengesa, është caktuar znj. Adelina Shala si zyrtare përgjegjës për qasje në dokumente publike.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Rektorit, Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore, Kryesuesit të IT, Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2223 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10 09 2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**

**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë Dt. 10.09.2024**

Në mbështetje të nenin 41 pika 1.1. të Statutit Nr. 04 -V- 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe nenit 5 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) - Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** z. Veton Jahmurataj – Drejtor i Bibliotekës në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, caktohet si zyrtar përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit .

**II.** I lartpërmenduri angazhohet për këtë detyrë shtesë nga data 10.09.2024.

**III.** I lartpërmenduri obligohet që, në përputhje me Ligjin nr. 06/ L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, të kryejë pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit .

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Në bazë të vendimit nr. 2148 datë 03.09.2024 për dorëheqjen dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punë së nëpunësit z. Butrint Xhemajli dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) - Nr. 03/2021 për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, i cili parashikon se në rast të dorëheqjes së zyrtarit përgjegjës, punëdhënësi është i obliguar të nxjerr vendim për caktimin e zyrtarit të ri përgjegjës, andaj është vendosur që z. Veton Jahmurataj të caktohet si zyrtar përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, për të siguruar vazhdimësinë e zbatimit të detyrave dhe përgjegjësive sipas ligjit dhe rregullores së lartpërmendur.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Të lartpërmendurit, Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit, Zyrës së Personelit, Kryesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2152 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 04.09.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në bazë të nenit 41 të Statutit nr. 04-V- 622 të Universitetit " Haxhi Zeka" Pejë, si dhe në përputhje me vendimet përkatëse për ndërprerjen e kontratës së punës të ish – nëpunësve znj. Fitore Ajdini - Gjuka dhe z. Butrint Xhemajli, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I.** Themelohet komisioni për evidentimin e dokumenteve dhe aseteve të ish – nëpunësve znj Fitore Ajdini - Gjuka dhe z. Butrint Xhemajli, në këtë përbërje:

1. Adnan Lataj - Kryetar
2. Muhamet Muriqi - anëtar
3. Agon Gashi – anëtar

**II.** Komisoni është i obliguar të evidentojë të gjitha dokumentet, paisjet dhe asetet që ishin në posedim të ish- nëpunësve znj. Fitore Ajdini Gjuka dhe z. Butrint Xhemajli , në përputhje me përgjegjësit e tyre zyrtare.

**III.** Komisioni duhet të hartojë një raporte të detajuar mbi gjendjen e dokumenteve dhe aseteve duke përfshirë inventarizimin e çdo materiali, pajisjeje ose mjeti tjetër që i përket institucionit.

**IV.** Ish nëpunësit znj. Fitore Ajdini- Gjuka dhe z. Butrint Xhemajli duhet të jenë të pranishëm gjatë procesit të evidentimit të dokumenteve dhe aseteve për të garantuar saktësinë dhe transparencën e procedurës. Ata duhet të nënshkruaj procesverbalin për pranimin dhe dorëzimin e aseteve dhe dokumenteve që i përkasin institucionit.

**V.** Raporti përfundimtar i evidentimit të dokumenteve dhe aseteve duhet të dorëzohet tek zyrtari/ja përgjegjëse.

**VI.** Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

U.d. Sekretari i Përgjithshëm
LLM. Tirana Baftiu – Hasani

**Vendimi i dërgohet:** Anëtarëve të Komisionit, Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur, Zyrtares për asete, Arkivit të UHZ-së.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2148 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 03.09.2024 Pejë / Peć

U.d. Sekretari i Përgjithshëm

Pejë Dt. 03.09.2024

Në mbështetje të nenit 75 paragrafi 1 dhe nenit 87 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe njoftimit përmes emailit zyrtar të datës 03. Shtator 2024 , nxjerrë këtë:

## V E N D I M

I. **Aprovohet** kërkesa datë 03.09.2024 për dorëheqjen dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së nëpunësit z. Butrint Xhemajli nga pozita U.d. Drejtor për Marrëdhënie me Publikun në Universitetin " Haxhi Zeka " Pejë.

II. Obligohet zyra e financave që të vazhdoj me procedurat e mëtejshme.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Me anë të njoftimit për dorëheqje, të dërguar përmes emailit zyrtar më datë 03.09.2024, z. Butrint Xhemajli U.d. Drejtor për Marrëdhënie me Publikun në Universitetin " Haxhi Zeka " Pejë, ka paraqitur kërkesën e tij për dorëheqje nga pozita e tij. Dorëheqja është bërë në mënyrë të njëanshme, duke kërkuar ndërprerjen e kontratës së punës në përputhje me Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton të drejtat e nëpunësve për të kërkuar dorëheqje dhe rregullat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të kushteve ligjore, është konstatuar se kërkesa e z. Butrint Xhemajli përmbushë të gjitha kriteret ligjore për ndërprerjen e kontratës së tij të punës.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi, duke obliguar edhe zyrën e Financave për të ndjekur procedurat e mëtejshme për përfundimin e detyrimeve financiare të lidhura me këtë vendim respektivisht ndërprerjen e njëanshme të kontratës së punës nga pozita e lartpërmendur.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Rektorit, Drejtorit të ASHP, Zyrës së Financave; Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore, Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI / UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2122 Nr. faq/ Br. str / Page 1
Data / Datum / Date 30 08 2024 Pejë

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm**

**Pejë, 28.08.2024**

Duke u bazuar në neni 41, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, dhe nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Themelohet Komisioni i Ankesave ad-hoc për procesin e konkursit publik nr.1967 dt.29.07.2024 për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, në përbërje si në vijim:

1. Veton Jahmurataj, Drejtor i Bibliotekës – Kryetar;
2. Shqipe Loshaj - Sekretare e njësisë akademike/ Fakulteti i Arteve – anëtare;
3. Diliko Kaçi, Zyrtare e Burimeve Njerëzore – anëtar.

II. Kompetencat e Komisionit të Ankesave janë: shqyrton ankesat kundër vendimit për verifikimin paraprak; shqyrton ankesat kundër vendimit për vlerësimin e rezultateve të testimit dhe shkrim; shqyrton ankesat kundër vendimit për vlerësimin e intervistës me gojë; dhe harton raporte pune pas çdo faze të ankesave.

III. Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

## Arsyetim

Sipas nenit 25 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, pjesë e Komisionit të Ankesave duhet të jetë edhe një zyrtar përkatës i fushës për të cilin është shpallur procedura e konkursit publik nr.1967 dt.29.07.2024. Mirëpo, për shkak të mungesës së kuadrove në fushën përkatëse për të cilën është shpallur procedura e konkursit publik, caktohet një zyrtar (Veton Jahmurataj) me përgatitje dhe përvojë profesionale në fushën për të cilën është shpallur procedura e konkursit publik.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, Zyres së Personelit, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2084 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Data: 27.08.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

U.d. Sekretar i Përgjithshëm

Pejë, 27.08.2024

Në bazë të nenit 38 paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Administratës Qendrore të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. **Autorizohet: z. Armend Alimusaj** që përveç detyrave të parashikuara si ushtrues detyre i Drejtorit të Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme, nga data 27.08.2024 deri në zgjedhjen e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, të kryej edhe detyrat e Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore si punë shtesë.

II. Ky vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi tjetër.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Ky vendim është marrë në përputhje të plotë më aktet ligjore dhe me nevojën për të siguruar vazhdimësinë dhe funksionimin e pandërprerë të Zyrës për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, pas mbetjes vakant të pozitës së Drejtorit të kësaj zyre.

Me datë 29.07.2024 Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, ka shpallur konkursin me nr.1967 për pozitën Drejtor i Zyrës për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore. Për shkak të mbetjes vakante të kësaj pozite z. Alimusaj është autorizuar që përvec detyrës së u.d. Drejtorit të Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme, të kryejë edhe detyrat e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore deri në zgjedhjen e Drejtorit për BNJ dhe BGJ.

Vendimi i mundëson universitetit të ruajë efikasitetin operacional dhe të vazhdojë me procedurat e konkursit pa ndërprerë, duke mbuluar detyrat e tjera brenda Zyres së Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore dhe duke siguruar që nuk do të ketë boshllëk në zbatimin e politikave për barazi gjinore gjatë kësaj periudhe tranzitore.

Prandaj, duke marrë parasysh arsyetimet e mësipërme, u vendos si në dispozitiv të këtij vendmi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" SEKRETARI I PËRGJITHSHËM – GENERALNI SEKRETAR – MMXI-2011

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2087 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 27.08.2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**

**"HAXHI ZEKA"**

**27.08.2024**

Duke u bazuar në neni 41, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, dhe nenit 24 të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet Komisioni Vlerësues ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, në Administratën Qendrore, në përbërje si në vijim:

1. Fatmire Thaçi, U.d. Sekretare e FSHTB – Kryetar;
2. Valbona Luta - Drejtor për Çështje Studentore – anëtare;
3. Adnan Lataj, Drejtor i IT - anëtar;
4. Diana Shala, Drejtor për Buxhet dhe Financa - anëtare
5. Armend Alimusaj - U.d. Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore – anëtar.

**II.** Kompetencat e Komisionit Vlerësues janë: përzgjedhë dhe cakton pyetjet dhe esenë e testimit me shkrim; vlerëson testimin me shkrim të kandidatëve; interviston dhe vlerëson kandidatët gjatë fazës së intervistave dhe harton raport të punës pas çdo faze të konkursit.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

### Arsyetim

Sipas nenit 24 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publikë, pjesë e Komisionit Vlerësues duhet të jetë edhe mbikëqyrësi i pozitës. Mirëpo, për shkak të konfliktit të interesit ndërmjet kandidatit në konkurs znj. Afrodita Gashi, dhe ushtrueses së detyrës së Sekretares së Përgjithshme , bëhet zëvendësimi me znj. Fatmire Thaçi ushtruese e detyrës së Sekretares së FSHTB.

Në përputhje me vendimin nr. 2084 të datës 27.08.2024 z. Armend Alimusaj, ushtrues detyre Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshme nga data 27,08.2024 autorizohet që si punë shtesë të kryej edhe detyrat e ushtruesit të detyrës Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyres së Personelit, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

Nr. 2085

Data / Datum: 27.08.2024 Pejë

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**

**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë Dt. 27.08.2024**

Në mbështetje të nenit 75 paragrafi 1 dhe nenit 87 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe kërkesës me nr. 2012, datë 07.08.2024, nxjerr këtë:

# V E N D I M

I. **Aprovohet** kërkesa me nr. 2012, datë 07.08.2024 për dorëheqjen dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së nëpunëses znj. Fitore Ajdini Gjuka nga pozita Zyrtar për mbikëqyrje të ndërtimeve në Universitetin " Haxhi Zeka " Pejë.

II. Obligohet zyra e financave që të vazhdoj me procedurat e mëtejshme.

III. Ky vendimi hynë në fuqi me datë 02.09.2024.

## A r s y e t i m

Me anë të kërkesës nr. 2012, datë 07.08.2024 znj. Fitore Ajdini Gjuka zyrtare për mbikëqyrje të ndërtimeve në Universitetin " Haxhi Zeka " Pejë, ka paraqitur njoftimin për dorëheqje nga detyra e saj. Dorëheqja është bërë në mënyrë të njëanshme, duke kërkuar ndërprerjen e kontratës së punës sipas nenit 75 paragrafi 1 dhe nenit 87 paragrafi 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, të cilët përcaktojnë të drejtat e nëpunësit për të kërkuar dorëheqje dhe rregullat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimit të kushteve ligjore, është konstatuar se kërkesa e znj. Fitore Ajdini Gjuka përmbush të gjitha kriteret ligjore për ndërprerjen e kontratës së saj të punës. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi , duke obliguar edhe Zyrën e Financave për të ndjekur procedurat e mëtejshme për përfundimin e detyrimeve financiare të lidhura me këtë vendim respektivisht ndërprerjen e njëanshme të kontratës së punës nga pozita e lartëpërmendur.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme

Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës; Rektorit, Prorektores për Buxhet. Financa dhe Infrastruktur, Drejtorit të ASHP, Zyrës së Financave; Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Barazi Gjinore, Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2065 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date 26.08.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

U.d. Sekretar i Pëgjithshëm

Pejë Dt. 26.08.2024

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3, nenit 49 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3. të Ligjit nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative, dhe kërkesës nr.2064 dt. 26.08.2024, nxjerrë këtë:

# V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa me nr. 2064 dt. 26.08.2024 e znj Afrodita Gashi për dorëheqjen nga pozita U.d. Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Administratën Qendrore të UHZ-së.

II. Shfuqizohet vendimi nr. 2809 datë 28.09.2023 për U.d. Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në kuadër të UHZ-së.

III. Nëpunësja znj. Afrodita Gashi rikthehet në pozitën Zyrtare për Financa në Fakultetin Juridik.

IV. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për financa, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

V. Obligohet zyra e financave që ta bëjë pagesën sipas pozitës Zyrtar për financa.

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës; Dekanit të F.Juridik; U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Sekretares së njësisë akademike – F.Juridik; Zyres së Financave; Zyres së Burimeve Njerëzore, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1884 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 23.07.2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**
**"HAXHI ZEKA"**

---

Në mbështetje të nenit 10,11 dhe nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, nenit 49 të Ligjit nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 38 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, si dhe kërkesës së parashtruar me shkrim përmes postës elektronike nga z. Gramos Buçinca Udhëheqës i Hulumtimit në Organizatwn për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA dt. 22.07.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

I. Për lejimin e qasjes së z. Gramos Buçinca Udhëheqës i Hulumtimit në Organizatën për Rritjen e Cilësisë në Arsim - ORCA në dokumentet e kërkuara: raportin financiar për vitin 2023 të Universitetit "Haxhi Zeka".

II. Obligohet që kërkuesi për qasje në dokumentet e kërkuara që t'i përmbahet dispozitave të Ligjit nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** ___________

**Data 23/07/2024**

**Vendimi t'i dërgohet:** Gramos Bucinca(ORCA), Prorektores pwr buxhet, financa dhe infrastruktur, U.d. Sekretarit të Përgjithshëm dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1798 Nr. i faq/ Br. str. No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.07.2024 Pejë

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm**

**Pejë, 15.07.2024**

Në bazë të Rregullores MF-NR.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore dhe nenit 183 të Statutit nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" – Pejë, U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet komisioni për vlerësimin e inventarit ( kondicionerëve) në Objektin e Rektoratit dhe në Fakultetin Juridik në Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, në këtë përbërje:

1. Petrit Bajraktari - Zyrtar për çështje studentore/ kryetar;
2. Agon Buquku - Ekspert i TI/ anëtar;
3. Rahim Hoti - Zyrtar teknik adm./ anëtar.

**II.** Komisoni është i obliguar që të hartoj raport me shkrim lidhur me vlerësimin dhe funksionalitetin e inventarit ( kondicionerëve) në objektin e Rektoratit dhe Fakultetin Juridik sipas kërkesave të parashtruara..

**III.** Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

## Arsyetim

Duke u bazuar në kërkesën nr. 1371 dt.21.05.2024, nr. 1559 dt. 13.06.2024 dhe nr. 1719 dt. 05.07.2024 për ndërrimin e kondicionerëve( klimave) në Zyren për çështje studentore në Fakultetin Juridik , Zyren e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Institutit për Shkencë dhe Arte, si dhe në zyrën e prorektores për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore në objektin e Rektoratit, Komisioni i lartëcekur është i obliguar që të bëjë vlerësimin e inventarit ( kondicionerëve) në këto objekte se a janë funksionale apo hiqen nga përdorimi për shkak të amortizimit të tyre apo dëmeve.

Detyrat, obligimet dhe përgjegjësit e komisionit janë të bëjnë klasifikimin e inventarit, në inventarin i cili mund të shfrytëzohet dhe inventarin i cili është i papërdorshëm dhe jashtë funksionit.

Komisioni i referohet Rregullores MF-NR.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

U.d. Sekretari i Përgjithshëm
LLM. Tirana Baftiu – Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Anëtarëve të Komisionit; Asistentes së Rektorit; Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur; Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1792 | Nr. i faqj/ Br. str. No pg. 2
Data / Datum / Date: 15.07.2024 Pejë

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretari i Përgjithshëm** **Pejë, 12.07.2024**

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, dhe vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024 , U.d. Sekretarja e Përgjithshme e UHZ, nxjerr:

**V E N D I M**

**I.** Laura Platkowska-Prokopczyk e angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror (UNISUM-2024), të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumë prej 245 euro (dyqind e katërdhjetë e pesë euro).

**II.** Kompenzimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref.nr. 1309 të dt. 17.05.2024.

**III.** Obligohet zyra e financave të UHZ-së, për ekzekutimin e këtij vendimi.

**IV.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Vendimi t' i dërgohet:**

- Laura Platkowska-Prokopczyk;
- Prorektorit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë;
- Prorektores për buxhet, financa dhe infrastruktur;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyres së Financave;
- Arkivit të Universitetit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B. Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1708 | Nr. i faq/ Br. str. No. pg 3

Data / Datum / Date 04 07 2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretar i Pëgjithshëm** **Pejë Dt. 04.07.2024**

Në mbështetje të nenit 5, 7 dhe nenit 9 paragrafi pika 3 dhe 8 të Rregullores MF-nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatën buxhetore , si dhe nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe kërkesës nr. protokoli 335 dt. 02.04.2024, nxjerrë këtë:

## V E N D I M
## PËR DHURIMIN E PASURISË JO FINANCIARE

I. **Aprovohe**t kërkesa me nr. protokolit: 335 datë 02.04.2024 e SHFMU " Tetë Marsi" Pejë.

II. I dhurohen 25 monitorë, shtëpiza, tastierë, mausa dhe gjashtë (6) UPS, SHFMU " Tetë Marsi" Pejë.

III. Paisjet e dhuruara largohen nga përgjegjësia e Uhz-së, si dhe nga sistemi i e-pasurisë.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së parashtruar nga SHFMU " Tetë Marsi" Pejë, me nr. protokolli 335 dt. 02.04.2024 për dhurimin e kompjuterëve të cilët janë jashtë përdorimit në UHZ, por janë në gjendje të rregullt, si dhe rekomandimit nr. prot. 1707 dt. 04.07.2024 të Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare në UHZ, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, komisioni ka vlerësuar se kompjuterët e dhuruar i plotësojnë nevojat elementare për përdorim për kabinetin e informatikës në kuadër të SHFMU " Tetë Marsi" Pejë, andaj u vendos, si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Kryetarit të KDSH – z.Fadil Zekaj; znj. Leonora Shoshi; Rektorit; U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Zyres së Financave; Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1658 Nr. i faq/ Br. str. / No. pg 1

Data / Datum / Date: 01/07/2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**
**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm**

**Pejë: 01.07.2024**

Në mbështetje të nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. Znj. Fatmire Thaçi - Zyrtare për Çështje Juridike në njësinë akademike / Fakulteti i MTHM -së, caktohet ushtrues detyre i Sekretarit të Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore.

II. E lartëcekura detyrën do ta ushtrojë nga dt. 02.07.2024, deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Me qëllim të themelimit (krijimit) të Njësisë së re Akademike – Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore në kuadër të UHZ-së,(vendimi nr. 1308 datë 17.05.2024) dhe sipas Statuti të UHZ-së, parashihet që Sekretari i njësisë akademike është bartës i zyrës administrative të njësisë akademike. Ky rol është vendosur për të siguruar që procesi i punës në këtë njësi të re akademike të vazhdojë normalisht dhe pa ngecje. Prandaj, për funksionalizimin e kësaj pozitë, u vendos siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës; U.d. Dekanit të FSHTB, Dekanit të Fakultetit të MTHM; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Sekretares së FMTHM; Zyres së Burimeve Njerëzore; Zyres për Buxhet dhe Financa; Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1449 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 30.05.2024 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**
**"HAXHI ZEKA"**

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm** **Pejë: 30.05.2024**

Në bazë të nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 38 dhe 41 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, U.d. Sekretari i Përgjithshëm, nxjerrë këtë:

## VENDIM

**I.** Shfuqizohet vendimi nr. 948 dt. 15.04.2024.

**II.** Znj. Fatmire Thaçi - Zyrtare për Çështje Juridike në njësinë akademike / Fakulteti i MTHM -së, caktohet ushtrues detyre i Sekretarit të Fakultetit të MTHM.

**III.** E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si ushtrues i detyrës së Sekretarit të Fakultetit të MTHM -së, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr. 247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

**IV.** E lartëcekura detyrën do ta ushtrojë nga dt. 03.06.2024, deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

**V.** Të gjitha kompetencat , përgjegjësitë dhe benificionet e parapara me përshkrimin e vendit të punës të Sekretarit të Fakultetit të MTHM-së, gjatë ushtrimit të pozitës së lartëcekur kalojnë tek znj. Fatmire Thaçi.

**VI.** Vendimi hynë në fuqi me datë 03.06.2024.

## Arsyetim

Bazuar në vendimin nr. 1439 datë 29.05.2024, për lejimin e pushimit pa pagesë për një periudhën një mujore nga data 03.06.2024 deri më datë 30.06.2024, për znj. Besa Baloku – Sekretare e Fakultetit të MTHM-së, për përkujdesjen e katër (4) fëmijëve të saj të vegjël dhe duke marrë parasysh se znj. Fatmire Thaçi është Zyrtare për Çështje Juridike në të njëjtën njësi akademike, u vendos që me qëllim që procesi i punës në këtë njësi akademike të vazhdojë normalisht dhe pa ngecje, të ndërmerren masat e parashikuara në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës; Dekanit të Fakultetit të MTHM; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Sekretares së FMTHM; Zyres së Burimeve Njerëzore; Zyres për Buxhet dhe Financa; Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1439 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 3

Data / Datum / Dato: 29.05.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm** **Pejë: 29.05.2024**

Në bazë të nenit 38 dhe 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, kërkesës me nr. prot. 1434 datë 28.05.2024 të znj. Besa Baloku, Sekretare në Fakultetin Menaxhimi në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis dhe rekomandimit me Ref. Nr. 1435 të dt. 28.05.2024, të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të saj, U.d. Sekretari i Përgjithshëm, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

I. Znj. Besa Baloku, Sekretare në Fakultetin Menaxhimi në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, i lejohet pushimi pa pagesë prej datës 03.06.2024 deri më 30.06.2024.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës së znj. Besa Baloku, Sekretare në Fakultetin Menaxhimi në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis, për marrjen e pushimit pa pagesë për përkujdesjen e katër fëmijëve të saj të vegjël, si dhe duke u bazuar në ligjshmërinë e lartcekur U.d. Sekretari i Përgjithshëm, vendosi të aprovoi kërkesën e Znj. Besa Baloku për lejimin e pushimit pa pagesë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretar i Përgjithshëm
''Universiteti Haxhi Zeka'' - Pejë

**Vendimi t'iu dërgohet:** Të lartpërmendurës; Dekanit të Fakultetit të MTHM; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Zyres së Burimeve Njerëzore; Zyres për Buxhet dhe Financa; Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1438 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 28.05.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë Dt. 28.05.2024

Në bazë të nenit 49 dhe nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 38 dhe 41 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, si dhe kërkesës datë 19. 05.2024 për ndërprerjen e pushimit pa pagesë, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. **Shfuqizohet** vendimi nr. 994 dt. 15.04.2024 për lejimin e pushimit pa pagesë për periudhën një vjeçare.

II. **Aprovohet** kërkesa datë 19.05.2024 e z. Liridon Cukaj për kthimin në punë në pozitën e njëjtë – Sekretar i Fakultetit të Biznesit.

III. I lartëcekuri kthehet në punë te punëdhënësi gjegjësisht në Njësinë Akademike/ Fakulteti i Biznesit prej datës 03.06.2024.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U.d. Sekretar i Përgjithshëm
LL.M. Tirana Baftiu-Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit; Dekanit të Fakultetit të Biznesit; U.d. Sekretarit të F. Biznesit; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Zyres së Burimeve Njerëzore; Zyres për Buxhet dhe Financa; Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1432 Nr. i Faq/ Br. str / No. pg 3

Data / Datum / Date. 28.05.2024 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm** **Pejë: 28.05.2024**

Në bazë të nenit 38, 41 të Statutit të UHZ-së, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, kërkesës me nr. prot. 608 datë 27.05.2024 të znj. Syzana Llolluni, asistente e dekanit në fakultetin e Biznesit dhe rekomandimit me Ref. Nr. 736 të dt. 27.05.2024, të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të saj, U.d. Sekretari i Përgjithshëm, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

I. **Znj. Syzana Llolluni**, Asistente e dekanit në fakultetin e Biznesit, i lejohet pushimi pa pagesë prej datës 29.05.2024 deri me 29.08.2024.
II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës së Znj. Syzana Llolluni, Asistente e dekanit në fakultetin e Biznesit, për marrjen e pushimit pa pagesë për përkujdesjen e dy fëmijëve të saj të vegjël, si dhe duke u bazuar në ligjshmërinë e lartcekur U.d. Sekretari i Përgjithshëm, vendosi të aprovoi kërkesën e Znj. Syzana Llolluni për lejimin e pushimit pa pagesë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani
____________________
U.d. Sekretar i Përgjithshëm
"Universiteti Haxhi Zeka" - Pejë

**Vendimi t'iu dërgohet:** Të lartpërmendurës; Dekanit të Fakultetit të Biznesit; Zyrës së Rektorit; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm; Sekretarit të njësisë akademike; Zyres së Burimeve Njerëzore; Zyres për Buxhet dhe Financa; Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1384 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 21.05.2024 Pejë Peć

**Vendim /MK/ /Datë: 21.05.2024**

Duke u në bazuar në nenin 59 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 183 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë Nr. 04 – V – 662 të datës 30 Maj 2013, si dhe duke u bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurimin publik, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë (UHZ) në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit me 21 Maj 2024, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet komisioni vlerësues për procedurën me titull: **"MIRËMBAJTJA FURNIZIM DHE MONTIMI ME MATERIAL ELEKTRIK PËR U.H.Z" - Nr. i prokurimit: UHZ-24-4235-2-2-1**

2. Anëtar të komisionit vlerësues, emërohen anëtarët, si në vijim:
   1. Muhamet Jupa - Zyrtar i Prokurimit / Kryetar;
   2. Admirim Sahara - Zyrtar teknik / Anëtar;
   3. Doruntina Avdijaj - Zyrtare për çështje studentore- NA Juridik / Anëtare

3. Detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara në Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 40, të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

4. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nuk do të shërbej si anëtarë i komisionit vlerësues, bazuar në nenin 39.4, të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të organizoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga ana e ZKA-së

**A r s y e t i m**

Departamenti i Prokurimit i UHZ-së më datë 20.05.2024, ka hapur ofertat lidhur me njoftimin e shpallur për kontratë për tenderin me titullI: **"MIRËMBAJTJA FURNIZIM DHE MONTIMI ME MATERIAL ELEKTRIK PËR U.H.Z" - Nr. i prokurimit: UHZ-24-4235-2-2-1;**

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Prorektor për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë Prof.
Ass. Dr. ~~Vjosa~~ Hajdari- Lleshi
për B. Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Anëtarëve të Komisionit Vlerësues; U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit të Prokurimit, Asistentes së Rektorit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1383 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 21.05.2024 Pejë / Peć

**Vendim /MK/** /Datë: 21.05.2024

Duke u në bazuar në nenin 59 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 183 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë Nr. 04 – V – 662 të datës 30 Maj 2013, si dhe duke u bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për prokurimin publik, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë (UHZ) në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit me 21 Maj 2024, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet komisioni vlerësues për procedurën me titull: **"Mbikëqyrje të punimeve ndërtimore ne UHZ" - Nr. i prokurimit: UHZ-24-3620-2-2-1**
2. Anëtar të komisionit vlerësues, emërohen anëtaret, si në vijim:
   1. Veton Jahmurataj - Drejtor i bibliotekës/ Kryetar;
   2. Afrodita Gashi - u.d. Drejtor për burime njerëzore dhe barazi gjinore / Anëtare;
   3. Muhamet Jupa - Zyrtar i Prokurimit / Anëtar.
